



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelit për vitin 2018

Në zbatim të pikave 2 dhe 3, të nenit 19, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Kolegji i Posaçëm i Apelit i ka parashtruar Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dokumentin e Raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelit për vitin 2018.

Në zbatim të kërkesave ligjore, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, ligjit nr. 109, datë 30.11.2017 “Për Buxhetin e vitit 2018”, pikës 101 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2018”, Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim Kolegji i Apelit) ka përgatitur Raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2018.

Buxheti i Kolegjit të Apelit për vitin 2018 është miratuar si pjesë e buxhetit të shtetit me ligjin nr.109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, i cili u rishikua në mbështetje të akteve normative nr.1, datë 26.07.2018 dhe nr.2, datë 19.12.2018.

Situata buxhetore për vitin 2018, në shpenzimet korrente dhe shpenzimet kapitale paraqitet në tabelën në vijim.

000/lekë

Programi	Artikulli buxhetor	Emërtimi	Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2018	Buxheti i rishikuar për vitin 2018 (Akti normativ nr. 1 dhe nr. 2)	Realizimi viti 2018	% realizimit
03340	600	Paga	100,000	86,503.5	84,117	97%
03340	601	Kontributi i shoqërore dhe shëndetësore	8,000	7,000	6,371	91 %
03340	602	Mallra e shërbime	20,000	9,000	7,186	80%
03340	230- 231	Investime	26,000	10,200	9,569.5	94%
		TOTAL	154,000	112,703.5	107,244.5	95%

Buxheti i miratuar me ligjin e buxhetit për vitin 2018, në shpenzime korrente (paga, sigurime shoqërore, blerje mallra shërbime) është 128,000 në mijë lekë. Buxheti i rishikuar i reduktuar, pas daljes së akteve normative nr. 1, datë 26.07.2018 dhe nr.2, datë 19.12.2018 është 102,503 mijë lekë dhe realizimi vjetor është 97,675 mijë lekë ose 95%.

I - Shpenzimet për paga (Ilogaria ekonomike 600)

Fondi i miratuar për paga, përbën 65% të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2018. Buxheti i miratuar në zërin paga për vitin 2018 është **100,000 mijë lekë**. Buxheti i rishikuar i reduktuar, sipas akteve normative të mësipërme është **86,503 mijë lekë** dhe realizimi **84,117 mijë lekë** ose **97%**.

II - Shpenzimet për sigurime shoqërore (Ilogaria ekonomike 601)

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore përbën 5% të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2018. Buxheti i miratuar në zërin sigurime shoqërore për vitin 2018 është **8,000 mijë lekë**. Buxheti i rishikuar, sipas akteve normative, është **7,000 mijë lekë** dhe realizimi **6,371 mijë lekë** ose **91%**.

Numri organik i punonjësve, bazuar në vendimin nr.101/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 Për miratimin e strukturës organizative, organikes dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit", është 43 punonjës. Numri mesatar i punonjësve për vitin 2018, ka qenë 34 vetë. Fondet në shpenzime personeli, të papërdorura për shkak të mosplotësimit të strukturës organike /largimit të punonjësve gjatë vitit, u pakësuan me aktin normativ nr.1(muaji korrik) dhe nr.2 (muaji dhjetor) në total rreth 14,500 mijë lekë.

III - Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime (Ilogaria ekonomike 602)

Mallrat dhe shërbimet e planifikuara në këtë zë janë të domosdoshme për mbështetjen e realizimit të veprimtarisë institucionale. Ky grup shpenzimesh përbën 13% të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2018. Buxheti i miratuar në shpenzime operative për vitin 2018 është **20,000 mijë lekë**. Buxheti i rishikuar i reduktuar, sipas aktit normativ të muajit dhjetor, është **9,000** dhe realizimi **7,186 mijë lekë** ose **80%**. Në mënyrë analitike realizimi paraqitet në tabelën në vijim:

Emërtimi	Realizimi për vitin 2018 (në lekë)
Materiale zyre dhe të përgjithshme (kancelari, letër, materiale pastrimi, tonera, libra publikime profesionale, dokumentacion specifik, uniforma , sinjalistika për dyert, ujë, etj)	4,000,684
Shpenzime të tjera operative (pagesë ekspert të jashtëm, kartëvizita, kartolina, shpenzime kompesimi pasaporta diplomatike, material hidraulike, marangozi, dekorim festa të fundvitit, qeramarrje foni boxer për seancat gjyqësore ,etj)	566,560
Shpenzime transporti (karburant, siguracion, parkim automjeti etj)	402,000
Shpenzime për furnizimin me energji	1,247,290
Shpenzime për furnizimin me ujë	30,650
Posta dhe shërbim korrieri + abonim në shtypin e shkruar	173,058
Shpenzime telefonike	765,758
TOTALI	7,186,000

Me buxhetin e miratuar në shpenzime operative u garantua mbështetja e aktivitetit operacional të institucionit me mallra e shërbime si; kancelari, leter, tonera, materiale pastrimi, regjistra gjyqësorë, karburant si dhe shpenzime të tjera të nevojshme për akomodimin në ambientet e reja në muajin qershor 2018. Gjithashtu u mbuluan shpenzimet për furnizimin me energji, ujë, shërbimin postar etj. Për vitin 2018, nuk u mundësua të përdorej fondi i detajuar në zërat udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit; trajnime dhe seminare; shpenzime për pritje-përcjellje; shpenzimet në energji dhe ujë (të cilat ishin parashikuar për një periudhë 1/vjeçare dhe u realizuan për vetëm 7 muaj), mirëmbajtje godine dhe pajisje (për shkak të akomodimit në

godinë të re) etj. Gjithashtu u krijuan fonde të lira si rezultat i procedurave të prokurimit kryesisht në toner, letër, kancelari, karburant etj.

Viti 2018, ishte viti i parë i ushtrimit të aktivitetit të plotë të Kolegjit. Bazuar në këtë eksperiencë, si dhe rezervat e krijuara me blerjet e kryera gjatë vitit 2018, do të merren masat për një përdorim të plotë dhe efektiv të buxhetit në shpenzime operative për vitin 2019.

Fondi i papërdorur në shpenzime operative u pakësua me aktin normativ nr.2, në muajin dhjetor 2018, në shumën 11,000 mijë lekë.

IV. Investime kapitale

Buxheti i miratuar me ligj në investime për vitin 2018 është **26,000 mijë lekë**. Buxheti i rishikuar sipas rialokimit të fondeve dhe aktit normativ nr.2, datë 19.12.2018, është **10,200 mijë lekë** dhe realizimi **9,569 mijë lekë** ose **94%**. Realizimi i fondit të investimeve, i detajuar sipas projekteve paraqitet:

		000/lekë		
Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Buxheti miratuar me ligj për vitin 2018	Buxheti rishikuar për vitin 2018	Realizimi i fondit për vitin 2018
M630002	Blerje pajisje dhe mobilie zyre	5,000	3,856.5	3,225.9
M630013	Blerje pajisje elektronike	900	3,669	3,669
M630021	Softëare te menaxhimit të çështjeve	2,200	0	0
M630022	Softëare aktiviteti financiar	300	120	120
M630012	Sistemi video sallë gjyqi	1,900	0	0
M630019	Pajisje scaner për kontroll, urë metali dedektor	12,700	0	0
M630020	Blerje automjeti për institucionin	3,000	2,554.5	2,554.5
TOTALI		26,000	10,200	9,569.5

Për vitin 2018, u realizua plotësimi i nevojës së institucionit për automjet; pajisje dhe mobilje për zyrat e gjyqtarëve dhe këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor (karrige, dollap metalik me celës, kasaforte, kënd kolltuku, veshje e dyerve etj) si dhe pajisje elektronike (lap top, projektor, diktofon, aparat forografik, kompjutera për punonjësit shtesë etj). Gjithashtu u realizua blerja e programit kompjuterik për mbajtjen e aktivitetit ekonomik dhe financiar të institucionit (programi “Financa V”).

Nuk u realizua fondi i detajuar për realizimin e sistemit video në sallën e gjyqit dhe skaner për kontroll.

Për vitin 2018 u detajua fondi 1,900 mijë lekë për realizimin e sistemit video në sallën e gjyqit i cili do të përshtatet me sistemin ekzistues audio. Për këtë në bashkëpunim me specialist të AKSHI-it, u hartua projekti me termat e referencës, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e sistemit 4 vjet në përputhje me dispozitat e VKM-së nr. 710, datë 21 gusht 2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”. Procedura e prokurimit u zhvillua 2 herë dhe në të dy rastet nuk u paraqit asnjë ofertë ekonomike dhe kishte mungesë konkurrence. Në kushtet e kohës së pamjaftueshme në dispozicion për të rishpallur përsëri këtë procedurë brenda vitit 2018, nuk u bë e mundur realizimi i kësaj procedure prokurimi. Sistemi audio është parashikuar të realizohet me buxhetin e vitit 2019 dhe procedurat e prokurimit janë përcaktuar në muajin mars, për të patur kohën e nevojshme në dispozicion për këtë qëllim.

Gjithashtu u detajua fondi 12,700 mijë lekë për skaner për kontroll dhe urë metali dedektor. Procedura e prokurimit për këtë objekt për mungesë stafi dhe ekspertize, ju delegua

Ministrisë së Brendshme. Kjo procedurë u zhvillua disa herë gjatë vitit 2018 dhe nuk u realizua dot.

Me shkresën nr.235 prot, datë 13.02.2019, Kolegji i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë; Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut; Ministres së Financave dhe Ekonomisë dhe për dijeni Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe ka kërkuar akordimin për vitin 2019, të buxhetit shtesë në shpenzime personeli dhe investime, për realizimin e skanerit për kontroll dhe urë metali dedektor.